REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.22.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga Udhëheqësi i ekipit, Arian Haxha dhe anëtareve të ekipit Adelina Selmani dhe Laureta Matoshi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 6

2 Qeverisja 9

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli 14

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit 23

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP 24

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak 27

Shtojca IV: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it 32


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin 2015 – i cili e përcakton opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) të sektorit publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 26/10/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinioni

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale. Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

MZHE nuk kishte hartuar strategjin gjithpërfshirëse të institucionit dhe nuk kishte dokumentuar procesin për menaxhimin e rreziqeve. Më tutje, auditimi i brendshëm nuk ka arritur të kryej vlerësimin e funksionimit të kontrolleve të brendshme.	Ministri duhet të inicojë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të institucionit, përcjellur me planin për menaxhimin e rreziqeve potenciale që do të kërcënonin arritjen e objektivave të synuara. Më tutje, duhet ti rishikoj arsyet e mos funksionimit të plotë të auditimit të brendshëm.(shih çështjet 2, 3 dhe 4).
Edhe pse janë bërë përmirësime në adresimin e rekomandimeve, një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar akoma nuk ishin adresuar dhe si pasoj mangësi të njëjta vazhdojn të përseriten nga viti në vit.	Ministri duhet të sigurojë që janë marrë veprime shtesë për adresimin e plotë të rekomandimeve dhe se të gjitha rekomandimet do të trajtohen me kujdes dhe përgjegjësi në të gjitha nivelet e menaxhimit.(shih çështjen 1).
Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive - ekzistojnë dobësi në disa sisteme të rëndësishme të menaxhimit financiar duke përfshirë subvencionet dhe menaxhimin e pasurisë.	Ministri duhet të ndermarrë veprime shtesë me qëllim eliminimin e mangësive në fushën e subvencioneve dhe menaxhimit të pasurisë (shih çështjet 12 dhe 13).

Përgjigja e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik - auditimi 2015

Ministri i Zhvillimit Ekonomik ka marrë në konsideratë të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit. Komentet e Ministrit për çështjet për të cilat nuk jemi pajtuar janë dhënë në detaje në Shtojcën IV.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë Zhvillimit Ekonomik është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarim materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

MZHE-ja kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e Ligjit të Buxhetit për 2015;
- Raportet tremujore, përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€;
- Raportet për borxhet e papaguara;
- Planin preliminar dhe final të prokurimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në Memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 16/12/2015, në lidhje me kornizën raportuese si dhe disa korrigjime të nevojshme në draft PVF janë adresuar nga menaxhmenti i MZHE-së.

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Po ashtu, në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MZHE-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzueseve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm, dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Zbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar si mjetë kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është marrë në konsideratë nga menaxhmenti i MZHE-së. Ky është një tregues që MZHE është munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe t'i forcoj kontrollet në disa fusha.

Megjithatë, ekzistojnë zbrazëtira në aranzhimet ekzistuese të qeverisjes në MZHE siç janë: mungesa e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit dhe menaxhimit të rreziqeve si dhe sistemi i auditimit të brendshëm nuk është plotësisht funksional. Këto fusha duhet të rishikohen si dhe të ndërmerren veprime konkrete për adresimin e tyre.

MZHE kishte strategjitë të sektoriale të zhvillimit ekonomik por nuk e kishte hartuar Strategjinë e përgjithshme të Ministrisë. Sipas sqarimit të dhënë nga MZHE dokumenti strategjik i Ministrisë është në pritje të aprovimit të strategjisë së përgjithshme të Qeverisë. Mungesa e planifikimit strategjik zbeh llogaridhënien dhe transparencën ndaj taksapaguesve lidhur me prioritetet e organizatës, përqendrimin e burimeve njerëzore dhe financiare, sigurimin se të punësuarit dhe aktorë të tjerë po punojnë drejt qëllimeve të përbashkëta. Mungesa e strategjisë, ka ndikuar edhe në pamundësinë e identifikimit të rreziqeve të organizatës.

Më tej, sistemi i auditimit të brendshëm si hallk kyçe e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk ka arritur të mbështesë menaxhmentin lidhur vlerësimin e kontrolleve të brendshme në ministri. Cilësia jo e mirë e planit vjetor dhe e raporteve të auditimit të brendshëm e kanë pamundësuar menaxhmentin në përfitimin e mundshëm. Lista kontrolluese e vetvlerësimit e plotësuar nga MZHE i pasqyron këto mangësi, megjithatë nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga menaxhmenti për adresimin e këtyre çështjeve.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të MZHE-së ka rezultuar në 13 rekomandime kryesore. MZHE kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, tetë (8) rekomandime janë implementuar plotësisht, katër (4) janë adresuar por nuk janë implementuar plotësisht, dhe një (1) nuk është adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Përkundër masave të ndërmarra, MZHE ende nuk ka arritur t'i adresoj plotësisht rekomandimet e dhëna nga AP. Si pasojë, mangësitë e njëjta në fushën e menaxhimit të pasurisë, ekzekutimin e buxhetit, auditimit të brendshëm janë përsëritur edhe në vitin 2015.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rrit rrezikun e përsëritjes së mangësive të njëjta në sistemet kryesore të menaxhimit financiar.

Rekomandimi 1 Ministri duhet të sigurojë që në vazhdimësi mbanë llogaridhënës personat përgjegjës të përcaktuar në planin e veprimit me qëllim të implementimit të rekomandimeve të AP-së sipas afateve kohore të përcaktuara me plan.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MZHE-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 – Lista kontrolluese e vetvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, ne i kemi shqyrtuar gjashtë (6) pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë (5) komponente. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. MZHE kishte strategjitë sektoriale të zhvillimit ekonomik por nuk e kishte hartuar strategjinë e e përgjithshme të Ministrisë. Sipas sqarimit të dhënë nga MZHE, dokumenti strategjik i Ministrisë është në pritje të aprovimit të strategjisë së përgjithshme të Qeverisë; dhe

2. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.2.

Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lart. Për më shumë, nuk janë ndërmarrë veprime për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetvlerësimi i vitit 2014. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda MZHE-së që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku

Mungesa e strategjisë së përgjithshme shkakton paqartësi rreth misionit vizionit dhe synimeve të institucionit dhe dobëson proceset strategjike dhe operative si dhe pamundëson hartimin e planit për menaxhim të rreziqeve. Kjo mund të ndikojë edhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 2

Ministri duhet të iniciojë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të MZHE-së, përcjellë me koston financiare që mund të ndikojë në arritjen e objektivave të synuara duke u bazuar në strategjinë e përgjithshme të qeverisë . Po ashtu, duhet të ndërmerr veprime për adresimin e fushave me dobësi të identifikuara në listën kontrolluese të vetvlerësimit.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MZHE operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Menaxhimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Dispozitat e LMFPP-së si dhe Rregulla Financiare e thesarit 01-2010 përcaktojnë që ZKA është përgjegjës për zbatimin e aranzhimeve, procedurave dhe sistemeve për të siguruar përmbushjen e objektivave kyçe të organizatës dhe për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet që mund të ndikojnë në arritjen e këtyre objektivave.

Çështja 3 – Mos zbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut- Prioritet i lartë

E gjetura	MZHE nuk kishte hartuar regjistrin për menaxhimin e rrezikut i cili duhet t'i paraprijë procesit të identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve me qëllim të zvogëlimit të tyre në nivel të pranueshëm. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së strategjisë së institucionit sepse fillimisht duhet caktuar objektivat e pastaj të identifikohen rreziqet që mund të ndikojnë në arritjen e tyre.
Rreziku	Menaxhimi jo efektiv i rrezikut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
Rekomandimi 3	Ministri duhet të sigurojë se regjistrat e rrezikut hartohen dhe shfrytëzohen nga menaxhmenti si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre.

2.5.2 Sistemi i auditimit të brendshëm

NjAB operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe një anëtarë. Komiteti i auditimit i përbërë nga tre anëtarë kishte mbajtur takime të rregullta ku ishin rishikuar në mënyrë kritike planet dhe rezultatet e auditimit të brendshëm.

Çështja 4 – Puna jo efektive e NjAB-së - Prioritet i lartë

E gjetura	Për të kryer një auditim të brendshëm efektiv nevojitet një program gjithë përfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të MZHE-së dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Plani vjetor i NjAB-it ishte hartuar në shtator të vitit 2015 sipas së cilit ishin planifikuar pesë (5) auditime prej të cilave vetëm tri (3) janë kryer gjatë vitit 2015. Plani vjetor i AB-së ishte përgatitur në fillim të vitit 2015, mirëpo për shkak të cilësisë jo të mirë, Komiteti i Auditimit nuk e kishte aprovuar atë deri në shtator 2015. Po ashtu, edhe cilësia e raporteve të finalizuara nuk ishte në nivelin e duhur. Në njërin prej tri raporteve të kryera "Auditimi i Aeroportit të Gjakovës", ishin dhënë vetëm përshkrime të marrëveshjes për monitorim dhe kontroll por jo edhe ndonjë vlerësim apo rekomandim për përmirësim.
Rreziku	Mos përgatitja me kohë dhe në mënyrë cilësore e planit vjetor të auditimit dhe moskryerja e auditimeve nga NJAB-i, ndikon në mos identifikimin me kohë të dobësive të kontrolleve të brendshme dhe mos përmirësimin e tyre.
Rekomandimi 4	Ministri duhet të analizojë arsyen e përgatitjes me kohë dhe në mënyrë cilësore të planit vjetor dhe mos kryerjen e auditimeve nga NjAB-i si dhe të ndërmarrë masa për funksionalizimin e NjAB-it si pjesë e rëndësishme e kontrollit të brendshëm.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

MZHE kupton rëndësinë e kontrolleve të forta mbi shpenzimet dhe gjatë vitit 2015 kontrollet kanë funksionuar relativisht mirë. Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të Ministrisë.

Procesi buxhetor në 2015, krahasuar me vitin 2014 është përmirësuar dukshëm. Si rezultat, buxheti final për 2015 është realizuar 95% me një rritje prej 4% krahasuar me vitin 2014. Mirëpo, edhe më tutje, vëmendje duhet t'i kushtohet dinamikës së shpenzimeve me qëllim të evitimit të shpenzimeve në fund vit dhe klasifikimit të gabuar të buxhetit.

Po ashtu, menaxhimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime si dhe investime kapitale është përmirësuar dukshëm, edhe pse ende ekzistojnë disa mangësi specifike në këto dy fusha.

Trajtim i veçantë duhet t'i kushtohet menaxhimit të subvencioneve. Edhe pse, janë bërë përmirësime në këtë fushë, subvencionimi i energjisë elektrike për rastet sociale duhet të shqyrtohet në nivel të Qeverisë. Rastet sociale janë aktivitet i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Listat aktuale që mbështesin këtë subvencionim nuk ofrojnë dëshmi të mjaftueshme për vlefshmërinë e përfituesve.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MZHE dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final1	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**27,358,051**	**25,882,153**	**23,609,109**	**26,518,897**	**37,229,741**
Granti i Qeverisë -Buxheti	25,098,051	22,410,118	22,097,977	26,015,230	36,780,568
Financimi nga Huamarrja	2,260,000	3,411,000	1,473,724	0	0
Donacionet e jashtme	0	61,037	37,409	503,667	449,173

Buxheti fillestar për 2015 kishte pësuar ndryshime si rezultat i zvogëlimeve nga granti qeveritarë dhe rritjeve përmes financimit nga huaja dhe nga donacionet e jashtme. Si rezultat, buxheti final ishte më i ulët nga buxheti fillestar për 1,475,898€. Për më shumë shiko faqen tjetër.

Realizimi i përgjithshëm i buxhetit ishte 95% nga buxheti final me një rritje prej 4% krahasuar me vitin 2014.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**27,358,051**	**25,882,155**	**23,609,109**	**26,518,897**	**37,229,741**
Pagat dhe Mëditjet	1,028,000	947,753	947,753	875,000	783,677
Mallrat dhe Shërbimet	5,363,669	4,308,538	3,728,096	3,115,134	4,676,347
Shërbimet komunale	36,210	46,210	43,144	42,593	39,735
Subvencionet dhe Transferet	9,833,870	9,831,120	9,831,120	14,984,691	24,602,809
Investimet Kapitale	11,096,302	10,748,534	9,058,996	7,501,479	7,127,173

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për paga dhe mëditje është zvogëluar për 86,000€ sipas vendimeve të Qeverisë dhe më pas është rritur për 12,500€ sipas vendimit për fondin e kuadrove. Shpenzimet në këtë kategori në raport me vitet paraprake janë rritur si rezultat i zbatimit të kontratës kolektive për njohjen e përvojës së punës dhe pagesën e saj prej 0.5% për çdo vit të përvojës. Buxheti për këtë kategori është realizuar 100%.

[1] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për mallra dhe shërbime është zvogëluar për 1,300,000€ si rezultat i vendimit të Qeverisë dhe më pas është rritur për 200,000€ nga granti qeveritarë për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara për procesin e arbitrazhit në kontestin gjyqësor të ngritur për rastin PTK Vala. Shpenzimet në këtë kategori në raport me dy vitet paraprake janë zvogëluar si rrjedhojë e procesit në përmbyllje të " TC" Kosova e Re dhe zvogëlimit të shpenzimeve për angazhimin e Këshilltarëve të transaksionit në këtë proces. Buxheti për këtë kategori është realizuar 87%.
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për investime kapitale është rritur për 390,000€ përmes financimit nga huamarrja për projekte kapitale. Më pas, me vendim të Qeverisë është zvogëluar për 764,000€. Shpenzimet kapitale për vitin 2015 në raport me dy vitet paraprake janë rritur si rezultat i investimeve në projekte kapitale veçanërisht për "Projektin për ujë dhe kanalizim në zonat rurale të Kosovës". Buxheti për këtë kategori është realizuar 84%.
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për subvencione dhe transfere është zvogëluar për 2,750€. Shpenzimet e vitit 2015 në raport me vitet paraprake janë zvogëluar si rezultat i shkurtimeve që janë bërë në programin e ngrohjes së Qytetit -Termokos. Buxheti për këtë kategori është realizuar 100%.

Çështja 5 – Mos realizimi i buxhetit në mënyrë sistematike gjatë vitit 2015 – Prioritet i mesëm

E gjetura Megjithëse gjatë vitit 2015, kishte ngritje në nivelin e realizimit të buxhetit në krahasim me vitin e kaluar, një pjesë e madhe e buxhetit ishte realizuar në tremujorin e fundit. Kjo ka ndodhur sidomos tek kategoria e Investimeve kapitale dhe transfereve kapitale për Ndërmarrje Publike (NP), ku 55% e buxhetit ishte realizuar në tremujorin e fundit. Realizimi i ulët i buxhetit ishte arsyeja e shkurtimit të buxhetit për investime kapitale. Ndër shkaqet e mos realizimit të buxhetit ishin vonesat në zhvillimin e procedurave të prokurimit nga NP për projektet që financohen nga MZHE.

Rreziku Mos realizimi i buxhetit në mënyrë sistematike gjatë vitit, rrit rrezikun që në fund të vitit të bëhen shpenzime të pakontrolluara dhe se vonesat në realizimin e projekteve kapitale vështirësojnë arritjen e objektivave të synuara të organizatës.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të sigurojë se ka analizuar arsyet për mos realizimin e buxhetit për investime kapitale dhe transfere kapitale për NP në mënyrë sistematike gjatë vitit dhe të ndërmerr masa në bashkëpunim me NP-të që t'i eliminojë dobësitë qoftë në fazën e planifikimit ose ekzekutimit të buxhetit.

Çështja 6 – Dobësi në planifikimin/ klasifikimin e shpenzimeve – Prioritet i mesëm

E gjetura

Klasifikimi jo i saktë i buxhetit/shpenzimeve në dy rastet në vijim:

Pagesa për projektin "Studimi gjeologo gjeokimik, gjeomjedisor dhe resurset gjeoturistike të zonës së Gashit", në vlerë prej 34,690€ është klasifikuar si shpenzim për investime kapitale. Për nga natyra ky aktivitet i takon hulumtimit. Sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit nr 38[2] shpenzimet e hulumtimit nuk kapitalizohen por ato duhet të klasifikohen si mallëra dhe shërbime.

Projekti ishte vazhdimësi nga viti 2014, dhe kjo ka ndikuar në klasifikimin e gabuar të shpenzimeve.

Shpenzimet "Pastrimi i objektit të MZHE-së dhe Muzeut të Kristaleve në Mitrovicë" në vlerë prej 1,629€ janë paguar nga kodi ekonomik jo adekuat-botimet. Në planin kontabël ekziston kodi përkatës për regjistrimin e mirëmbajtjes së ndërtesave administrative.

Rreziku

Klasifikimi jo i saktë i shpenzimeve rrit rrezikun që pasqyrat financiare të mos japin një pamje të drejtë dhe të vërtet duke mbivlerësuar njërën kategori të shpenzimeve dhe nënvlerësuar kategorinë tjetër.

Rekomandimi 6

Ministri duhet të sigurojë se planifikimi dhe klasifikimi i projekteve të caktuara bëhet duke pasur për bazë planin kontabël të aprovuar nga Ministria e Financave.

[2] Standardi Ndërkombëtarë i Kontabilitetit nr. 38: "të gjitha shpenzimet e studimit/hulumtimit duhet të klasifikohen si shpenyime operative e nuk duhet të kapitalizohen për arsye se është e pamundur të tregohet nëse do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmën. Studimet janë në fazën fillestare të identifikimit të mineraleve e cila i përcakton mundësitë për investim."

3.4 Prokurimi

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos realizimit të aktiviteteve të prokurimit në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi gjatë procesit të vendimmarrjes në fazën e planifikimit ashtu edhe në fazën e vlerësimit të aktiviteteve të prokurimit.

MZHE mbështet Qeverinë në ushtrimin e detyrave të tij si aksionare e Ndërmarrjeve Publike (NP). Si pjesë e kësaj mbështetje, MZHE në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara për monitorimin dhe kontrollin transferon fonde për NP-të dhe Trepçën. Ndërmarrjet Publike i udhëheqin vet procedurat e prokurimit për fondet e përfituara nga MZHE. Kontrollet në këtë fushë kanë funksionuar mirë.

Rekomandim

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Ne kemi testuar gjithashtu shpenzimet për të cilat nuk kërkohet aplikimi i procedurave të prokurimit siç janë: shërbimet komunale, shpenzimet e reprezentacionit, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare dhe shpenzime tjera. Kontrollet në këtë fushë kanë funksionuar mirë, megjithatë duhet të ndërmerren veprime shtesë për eliminimin e mangësive në vijim.

Çështja 7 – Tejkalim i shpenzimeve të telefonisë mobile – Prioriteti i mesëm

E gjetura	Udhëzimi Administrativ (UA) nr. 04/2008 për përdorimin e telefonave, parasheh limitet për përdorimin e telefonave mobil dhe fiks. Në listën e muajit shkurt dhe qershor 2015, kishte tejkalime të shfrytëzimit të limiteve për mbushje me kartela grithëse për 10 zyrtarë pa aprovim paraprak nga Sekretari i Përgjithshëm.
Rreziku	Tejkalimi i limiteve të shpenzimeve të telefonisë mobile pa aprovim paraprak nga Sekretari mund të ndikojë në shfrytëzimin e buxhetit për qëllime jo zyrtare dhe pa justifikim të duhur.
Rekomandimi 7	Ministri duhet të shtoj nivelin e kontrolleve mbi menaxhimin e shpenzimeve të telefonisë mobile për t'i racionalizuar ato. Në rastet e nevojës për tejkalime duhet të shqyrtohet mundësia e aprovimeve paraprake ose në të kundërtën të shqyrtohet mundësia e ndalesave nga paga.

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollet që operojnë nga MZHE kanë të bëjnë llogaritjen e pagave në pajtim me kontratat e punës si dhe legjislacionit të aplikueshëm.

Numri i aprovuar për të punësuarit në MZHE ishte 153, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 145 punonjës. Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit, dosjet e personelit si dhe kemi rishikuar listat e pagave dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF.

Çështja 8 - Zyrtarë me marrëdhënie të rregullt pune nuk janë përfshirë në listën e pagave – Prioritet i mesëm

E gjetura Pesë (5) zyrtarë nga kabineti i Ministrit të cilët qysh nga muaji Janar 2015 kanë kontrata të rregullta pune nuk janë përfshirë në listën e pagave. Pagesa për këta zyrtarë është kryer nga kategoria mallra dhe shërbime që është në kundërshtim me rregullën e thesarit nr. 01/2013 neni 33 pika 1 sipas të cilës të gjithë të punësuarit që nënshkruajnë kontratë të rregullt pune duhet të regjistrohen në listën e pagave.

Rreziku Pagesa e zyrtarëve që kanë marrëdhënie të rregullt pune nga kategoria mallra dhe shërbime ndikon që buxheti të shpenzohet për qëllime tjera të paplanifikuara. Po ashtu, kjo ndikon edhe në mos përmbushjen e obligimeve ligjore për pagesën e kontributeve pensionale për stafin e punësuar.

Rekomandimi 8 Ministri duhet të sigurojë që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kanë vendosur të gjithë zyrtarët e punësuar që kanë marrëdhënie të rregullt pune në listën e pagave gjithnjë duke pasur parasysh numrin e aprovuar me ligjin e buxhetit.

3.5.2 Subvencionet dhe Transferet

Sipas politikës së brendshme të MZHE-së parashihen dhëniet e subvencioneve për NP për mbulimin e shpenzimeve operative dhe për mbulimin e shpenzimeve komunale të rasteve sociale dhe të minoriteteve. Një pjesë e subvencioneve ndahet për subvencionimin e shpenzimeve operative të ndërmarrjes shoqërore Trepça. MZHE ka një marrëveshje të lidhur me NSH Trepça ku parashihen format e dhënies dhe mënyra e monitorimit të këtyre pagesave.

Çështja 9 - Lista e paqartë e përfituesve të subvencioneve për rastet sociale dhe familjet e dëshmorëve - Prioritet i lartë

E gjetura

Pagesa e energjisë elektrike për përfituesit e skemës sociale dhe familjeve të dëshmorëve nga MZHE në bazë të listave të paqarta. Pagesa e energjisë elektrike për rastet sociale dhe për familjet e dëshmorëve është e rregulluar me marrëveshjen trepalëshe në mes të MZHE-së, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) - KEDS[3]. Sipas marrëveshjes, lista e përfituesve përgatitet nga MPMS dhe në bazë të saj MZHE e transferon buxhetin për financimin e përfituesve në KEDS.

Për këtë qëllim, në 2015, MZHE kishte transferuar në KEDS vlerën prej 4,490,933€. Mirëpo, lista e përfituesve e përgatitur nga MPMS sipas së cilës ishte bërë transferimi në KEDS kishte paqartësi si në vijim:

- 2 deri në 5 përfitues të skemës sociale kishin të njëjtin njehsorë,;
- disa përfitues nuk ishin pajisur me numër "KEK Number"; si dhe
- në disa raste në list ishte cekur vetëm nr. njehsorit elektrik por jo edhe adresa e përfituesit.

Megjithatë, MZHE nuk ka ndikim në hartimin apo përzgjedhjen e përfitueseve të skemës sociale. Hartimi dhe përzgjedhja e përfituesve është përgjegjësi e MPMS-së. Andaj, MZHE nuk ka mundur të verifikoj saktësinë e të dhënave në listat e përfituesve. Gjithashtu, e kishte të pamundur të verifikoj nëse KEDS kishte shlyer borxhet e familjeve të subvencionuara ngase për këtë çështje KEDS raporton vetëm në MPMS. Sidoqoftë, kjo çështje është e rëndësishme dhe duhet të trajtohet për të siguruar menaxhimin efektiv të buxhetit për subvencionimin e rasteve në fjalë.

Pagesa jo sipas afatit kohor të përcaktuar me marrëveshje. Sipas nenit 5 pika 1.1.4 të marrëveshjes së lidhur ndërmjet MZHE-së dhe INFRAKOS-it për , subvencionimi në vlerë prej 600,000€ për mbulimin e shpenzimeve të trenit të lirë të udhëtarëve do të transferohen në baza tre mujore përgjatë vitit. MZHE kishte transferuar shumën në total tek INFRAKOS në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015 jo në përputhje me marrëveshjen.

Sipas sqarimi të dhënë nga MZHE, pagesa para afatit është bërë me kërkesë të përfituesit për të financuar obligimet e dalura nga marrëveshja për qarkullimin e trenit të lirë.

[3] Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji elektrike- KEDS Sh.A,

Rreziku Pamundësia e verifikimit të listave të përfituesve dhe shlyerjes së borxheve rrit rrezikun që në listë të futen persona që nuk i plotësojnë kriteret për të qenë përfitues të këtyre skemave. Njëherit, vihet në dyshim shlyerja e borxheve të përfituesve nga KEDS përkundër transferit të mjeteve.

Më tutje, transferi i mjeteve tek INFRAKOS jo në përputhje me marrëveshjen mund t'i shkaktoj ministrisë vështirësi financiare në subvencionimin e aktiviteteve tjera të parapara me objektivat e MZHE-së.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të sigurojë që në bashkëpunim me Ministrin e Financave kanë shqyrtuar mundësin e transferit të buxhetit për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për rastet sociale dhe familjet e dëshmorëve në MPMS. Skemat e rasteve sociale janë aktivitet i MPMS dhe përgjegjësia për administrimin e këtyre listave i takon kësaj ministrie. Më tutje, transferi i mjeteve tek NP të bëhet në përputhje me afatet kohore të parapara me marrëveshjet.

3.6 Pasuritë dhe detyrimet

3.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1000€) ishte 11,693,000€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) ishte 80,000€. Auditimi jonë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi çështjet në vijim:

Çështja 10 – Mangësi në menaxhimin e pasurisë - Prioritet i mesëm

E gjetura Blerjet nga buxheti për Investime kapitale në vlerë prej 89,690€[4] janë regjistruar në regjistrin kontabël si pasuri mbi 1,000€, por që për kah natyra janë mallra dhe shërbime e jo investime kapitale. Kjo ka ndodhur për shkak të klasifikimit jo të drejt të buxhetit nga ana e MZHE-së

Sipas UA nr. 03/2008 për përdorimin e automjeteve zyrtare në raste të caktuara, për shkak të specifikave të posaçme të punës me vendim të ministrit të ministrisë përkatëse, mund të lejohet përdorimi i automjeteve zyrtare edhe jashtë orarit zyrtarë të punës me propozim të Sekretarit të përgjithshëm. Autorizime për shfrytëzimin e veturave jashtë orarit të punës për pesë (5) zyrtarë ishte lëshuar vetëm nga SP jo vendimi nga ministri siç kërkohet me këtë UA.

Më tutje, për veturat e shfrytëzuara nga kabineti i ministrit nuk mbahen evidenca për kilometrat e kaluara dhe karburantet e shpenzuara.

[4] "Studimi gjeologo gjeokimik, gjeomjedisor dhe resurset gjeoturistike të zonës së Gashit", në vlerë prej 34,690€ e paguar në vitin 2015, përderisa pjesa tjetër i takon blerjeve te të njëjtit projekt të vitit 2014.

Rreziku Regjistrimi i blerjeve si pasuri pa përmbushjen e kritereve për pasuri kapitale rezulton në mbivlerësim të pasurive të MZHE-së dhe njëherit mbivlerësim të pasurive të prezantuara në PVF. Ndërsa, mosrespektimi i procedurave për menaxhimin dhe përdorimin e automjeteve, ndikon në shfrytëzimin jo racional të tyre. Kjo mund të pasojë me kosto shtesë të karburanteve, si dhe shpenzime tjera rreth riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të sigurojë se regjistri i pasurisë pasqyron vetëm pasuritë të cilat i përmbushin kriteret për regjistrimin e tyre. Më tutje, shfrytëzimi i automjeteve jashtë orarit të punës është bërë vetëm pas një aprovimi paraprak nga vet Ministri. Po ashtu, evidencat lidhur me shfrytëzimin e automjeteve duhet të mbahen nga secili përdorues me qëllim të evitimit të përdorimit të tyre për nevoja jo zyrtare.

3.6.2 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 130,000€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. Të gjitha faturat e papaguara janë shpenzime të cilat janë pranuar pas mbylljes së periudhës së pagesave.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditivit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçë për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar/do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarim materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo te implementuara	Të pa adresuara
1. Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të sigurojë se rishikimi i buxhetit për vitin 2015 bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave për të gjetur klasifikimin e duhur për mbështetjen e Ndërmarrjeve Publike bazuar në Standardet e kontabilitetit të njohura ndërkombëtarisht dhe kriteret e konkurrencës nën Aquis Communautaire të BE-së.		Pjesërisht i implementuar	
1.1 Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të sigurojë që plani i hartimit të PVF 2015 përfshinë rishikimin e draft llogarisë nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse në draft PVF janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		Pjesërisht i implementuar	

2.Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, përcakton saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të vitit paraprak duhet të përcaktohen nga drejtorët relevant dhe të raportohen te Ministri.	Është implementuar		
2.Qeverisja e mirë	Ministri duhet të shqyrtojë aranzhimet ekzistuese të qeverisjes/llogaridhënies dhe kërkesave që i bëhen departamenteve dhe njësive për raportim. Po ashtu duhet të siguroj se ka përgatitur regjistrin e rreziqeve për të zbutur ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me arritjen objektivave të MZHE-së.		Është implementuar pjesërisht, regjistri i rreziqeve nuk është përgatitur.	

4. Shpenzimet	Ministri duhet të përcaktoj shkaktarët e gabimeve procedurale të identifikuara dhe të implementoj kontrolle/trajnime/rishikime mbikëqyrëse shtesë që të siguroj se rregulloret në fuqi po aplikohen në tërësi.	Është implementuar		
4.1 Shpenzimet	Ministri duhet të sigurojë që pas skadimit të kontratës me IPKO-në procedurat e prokurimit për shpenzime të telefonisë mobile të inicohen.	Është implementuar		
4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri duhet të sigurojë se kërkesat për financimin e udhëtimeve zyrtare vlerësohen sipas rregulloreve në fuqi dhe të financohen vetëm kur plotësohen kriteret e duhura.	Është implementuar		.
4.3 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri duhet të sigurojë se kontrollet efektive janë prezente për të siguruar identifikimin e hershëm të nevojave për të shmangur kontratat për shërbime të veçanta, dhe për të implementuar me kohë procedurat e duhura, si dhe të rishikoj pagesat për punëtorët e Aeroportit të Gjakovës.	Është implementuar		

5. Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se kontrollet janë rritur për të siguruar se vetëm ato blerje të cilat përmbushin kriterin për tu klasifikuar si pasuri mbi 1,000€ regjistrohen në regjistrat e pasurisë së MZHE-së.		Pjesërisht i implementuar	
5.1 Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha masat e nevojshme për ngritjen dhe adresimin e problemit të pasurisë përmes MAP-it dhe të gjitha pasuritë duhet të regjistrohen në e-pasuria.	Është implementuar		
6. Trajtimi i borxheve	Mos protokollimi i faturave rrit rrezikun e humbjes apo pagesës se dyfishtë të së njëjtës faturë. Ministri duhet të siguroj që zbatohen të gjitha procedurat kontrollit të brendshme për qarkullim të dokumentacionit.	Është implementuar		

7. Auditimi i brendshëm	Ministri duhet të shqyrtoj burimet dhe kapacitetin profesional ekzistues të NJAB-së dhe të sigurojë se një plan i auditimit me vlerësim të fuqishëm të rrezikut implementohet i mbështetur me staf adekuat dhe është subjekt i një rishikimi adekuat.			Nuk është adresuar
7.1 Auditimi i brendshëm	Ministri duhet të siguroj që Komiteti i ri emërohet sa më shpejtë të jetë e mundur i cili ka një vizion të qartë për mbështetjen dhe sfidimin e aktivitetit të NJAB në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira. KA duhet të luaj rol proaktiv në mënyrë që të këshillojë NJAB-in në mënyrë që aktivitetet e planifikuara të auditimit ti adresojnë qëllimet e organizatës, duke reflektuar objektivat strategjike operative afat-gjata, afat-mesme, afatshkurta.	Është implementuar		

Shtojca IV: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it

Te gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Pikëpamja e ZAP-it
E gjetura 2:	Jo	MZHE, Departamentet dhe Njësitë e saj, ka përgatitur Strategjitë sektoriale të zhvillimit ekonomik dhe me këtë proces janë përfshirë të gjithë resorët ekonomik që mbulohen me misionin dhe objektivat e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Sipas direktivave të Zyrës për planifikim strategjik, në Zyrën e Kryeministrit, nga OB-të është kërkuar që në të ardhmen të punohet në përgatitjen e një dokumenti strategjik gjithëpërfshirës dhe në këtë rast hartimi i Strategjisë së MZHE-së do të ishte i pakualifikuar.	Në komentin e paraqitur, MZHE nuk e mohon faktin se nuk ka një strategji gjithpërfshirëse të aprovuar por arsyeton mungesën e strategjisë. Sidoqoftë, sipas, procedurës nr.8 e MFK-së, OB duhet të hartojn planet strategjike në nivel të organizatës e cila ofron mbështetje për procesin e planifikimit operativ dhe lehtëson monitorimin e progresit drejt objektivave. Prandaj, rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.
E gjetura 5:	Jo	Bazë për shpenzimin e buxhetit vjetor të një NP-je është Ligji i buxhetit dhe ndarjet që janë bërë në emër të projektit përkatës. Në ligjin e buxhetit nuk ka kufizime kohore për shfrytëzimin e mjeteve financiare dhe shfrytëzimi i mjeteve në tremujorin e fundit të vitit është çështje që lidhet me realizimin e projekteve dhe plotësimin e kushteve ligjore për shfrytëzimin e fondeve. Megjithatë MZHE është përpjekur ne vazhdimësi për mundësin e shpenzimit te mjeteve nga NP – të ne harmoni me planin dinamik.	Në komentin e paraqitur, MZHE nuk e mohon realizimin e një pjese të konsiderueshme të shpenzimeve kapitale në tremujorin e fundit por vetëm jep sqarime për realizimin e tyre. Përkundër faktit se Ligji i buxhetit nuk cakton limite kohore, koncentrimi i shpenzimeve të mëdha në tremujorin e fundit rrezikon që procesimi i pagesave të mos i nënshtrohet kontrolleve të duhura dhe si pasoj ndodhjen e parregullsive gjatë procesimit të pagesave. Prandaj, rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.

E gjetura 6:	Jo	• Me UA Nr. 02/2013, Neni 3, Pasuri Kapitale – nënkupton të gjitha pasuritë financiare materiale dhe jo materiale që blihen. MZHE në Programin për Investime Kapitale ka projekte të natyrës studimore siç është: Studimet mbi pasuritë nën dhe mbitokësore të Kosovës. Regjistrimi i këtyre projekteve, në Pasuri kapitale e MZHE-së, është bërë në përputhje me Udhëzimin Administrativ 02/2013.	Sipa rregullorës 02/2013, neni 3, (të cilës MZHE i referohet në komentin e paraqitur) pasuri kapitale nënkupton të gjitha pasuritë të cilat: • kanë afat përdorimi më të gjatë se një vit dhe që synohet të përdoret vazhdimisht; • kanë vlerë mbi 1,000Euro; dhe • pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet tek Organizata Buxhetore. Sidoqoftë, shpenzimet e hulumtimit nuk kapitalizohen. Sipas Standardit Ndërkombëtarë të Kontabilitetit nr. 38 të gjitha shpenzimet e studimit/hulumtimit duhet të klasifikohen si mallra dhe shërbime e nuk duhet të kapitalizohen për arsye se është e pamundur të tregohet nëse do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmën. Studimet janë në fazën fillestare të identifikimit të mineraleve e cila i përcakton mundësitë për investim. Prandaj, rekomandimi ynë mbetet i pandryshuar.
E gjetura 7:	Jo	Personat e përfshirë në listën e mbushjeve të telefonit janë pjesë e listës së të gjithë zyrtarëve që marrin kartela mbushëse dhe e njëjta listë është miratuar formalisht nga Sekretari i Përgjithshëm i MZHE-së.	Në komentin e paraqitur, MZHE thekson se lista e zyrtarëve që marrin kartela mbushëse është miratuar formalisht nga Sekretari i Përgjithshëm. Mirëpo komenti i dhënë nuk është mbështetur me ndonjë dëshmi të dokumentuar për të vërtetuar se tejkalimi i limiteve për muajin shkurt dhe qershor 2015 është miratuar formalisht nga Sekretari i Përgjithshëm. Andaj rekomandimi ynë në këtë pikë mbetet i pandryshuar.

E gjetura 9:	Jo	• MZHE nuk ka ndikim dhe autoritet në hartimin apo përzgjedhjen e përfitueseve të skemës sociale. Kjo çështje i takon dhe është përgjegjësi e MPMS-së. Nga raportet e shpenzimeve të krijuara për çdo vit paraprak dhe nga procesi i rishqyrtimit të ankesave të përfitueseve të skemës sociale MZHE, bartë tek KEDS tërë shumën e paraparë, me Ligjin e Buxhetit, prej 4.5 mil. Euro. • Pagesa e subvencioneve më përpara se sa është paraparë me marrëveshje, te rasti i INFRAKOS-it, është bërë me kërkesë të përfituesit dhe ndikimit negativ financiar të kompanisë që ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së obligimeve që rrjedhin nga marrëveshja për qarkullimin e trenit të lirë.	Në komentin e paraqitur, MZHE nuk e mohon faktin se listat e përfituesve të subvencioneve sociale kanë mangësi por vetëm sqaron se listat përpilohen nga MPMS dhe se paraqitja e mangësive është jashtë kontrollit të tyre. Sikur në komentin paraprak, MZHE nuk e mohon faktin se pagesat janë kryer para afatit kohor të caktuar me marrëveshje por jep sqarimet rreth ndodhjes së tyre. Andaj, rekomandimi ynë në këtë pikë mbetet i pandryshuar
E gjetura 10:		Me UA Nr. 02/2013, Neni 3, Pasuri Kapitale – nënkupton të gjitha pasuritë financiare materiale dhe jo materiale që blihen. MZHE në Programin për Investime Kapitale ka projekte të natyrës studimore siç është: Studimet mbi pasuritë nën dhe mbitokësore të Kosovës. Regjistrimi i këtyre projekteve, në Pasuri kapitale e MZHE-së, është bërë në përputhje me Udhëzimin Administrativ 02/2013.	Shpenzimet e hulumtimeve për nga natyra e tyre nuk hyn në kategorinë e investimeve kapitale andaj nuk duhet të përfshihen në regjistrin e pasurive kapitale. Andaj, rekomandimi ynë në këtë pikë mbetet i pandryshuar. Për më shumë referojuni përgjigjeve tona ndaj komentit për të gjeturën me nr 6.